

20131643990

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURI DHE SHËNDET**  
**GJATË PUNËS**

Neni 1

Në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 92/2007, 136/11, 23/13, 25/13 dhe 137/13), pas nenit 17 shtohen 27 nene të reja 17-a, 17-b, 17-v, 17-g, 17-d, 17-gj, 17-e, 17-zh, 17-z, 17-x, 17-i, 17-j, 17-k, 17-ll, 17-l, 17-m, 17-n, 17-nj, 17-o, 17-p, 17-r, 17-s, 17-t, 17-q, 17-u, 17-f dhe 17-h, si vijojnë:

“Kushtet për dhënie të provimi profesional për siguri gjatë punës

Neni 17-a

(1) Provimi profesional jepet për kontroll të njohurisë së nevojshme profesionale nga sfera e sigurisë gjatë punës.

(2) Provim profesional mund të japë personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë vendbanim në Republikën e Maqedonisë,
- të ketë arsim të lartë nga mbrojtja gjatë punës, drejtimi teknik ose tjetër, i cili përputhet me veprimtarinë e punëdhënësit (diplomë për arsim të lartë të përfunduar katërvjeçar ose diplomë me 300 kredi sipas sistemit evropian për transfer të kredive (SETK)),
- me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa zgjasin pasojat nga ndalimi dhe
- të ketë së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit, në sferën përkatëse për të cilën është parashtruar kërkesa për dhënie të provimit profesional.

II. Mënyra e zbatimit të provimit

Neni 17-b

(1) Provimi përbëhet prej dy pjesëve, edhe atë:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve dhe
- pjesa e dytë (shembull praktik), me të cilën kontrollohet aftësia praktike e kandidatëve.

(2) Pjesa e parë e provimit nga paragrafi (1) i këtij neni jepet me shkrim në mënyrë elektronike, me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(3) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga:

- shembulli praktik dhe
- pyetje të cilave kandidati duhet t'u përgjigjet në bazë të analizës së shembullit praktik.

Neni 17-v

(1) Provimi jepet sipas programit në të cilin përmbahen materiali, rregullat dhe literatura.

(2) Programin për dhënie të provimit profesional për siguri gjatë punës e miraton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

Neni 17-g

(1) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë të provimit dhe bazat e shembujve praktikë për pjesën e dytë të provimit nga neni 17-b të këtij ligji i përpilojnë profesorë nga sfera përkatëse dhe nëpunës shtetërorë nga Inspektorati shtetëror i punës, të cilët kanë së paku 10 vjet përvojë pune në sferën përkatëse, të caktuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(2) Pyetjet nga pjesa e parë e provimit dhe pyetjet dhe shembujt praktikë nga pjesa e dytë e provimit i verifikon Komisioni i përbërë nga:

- tre përfaqësues nga Inspektorati shtetëror i punës, të emëruar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës,

- një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë i emëruar nga ministri kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë dhe

- një përfaqësues nga Instituti i mjekësisë së punës i emëruar nga ministri kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, kryen edhe revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë nga neni 17-b i këtij ligji, së paku një herë në vit.

(4) Gjatë revizionit Komisioni veçanërisht i ka parasysh ndryshimet e rregullave në të cilat bazohet pyetja përkatësisht shembulli praktik, numrin e kandidatëve të cilët i janë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kriteret tjera të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së bazave nga neni 17-b i këtij ligji.

(5) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë, Komisioni vendos që pyetjet dhe shembujt praktikë të ndryshohen apo të mënjnohen plotësisht nga bazat nga neni 17-b i këtij ligji.

(6) Profesorët dhe personat nga paragrafi (1) i këtij neni dhe anëtarët e Komisionit për verifikim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni kanë të drejtë në kompensim në para të cilin e cakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(7) Shuma e kompensimit me para nga paragrafi (6) i këtij neni caktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përpiluara dhe shembujve praktikë, si dhe ndërlikueshmërisë së materies.

(8) Kompensimi vjetor në para nga paragrafi (6) i këtij neni nuk e tejkalon nivelin e tri rrogave mesatare të paguara në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, të publikuara në Entin Shtetëror të Statistikës.

#### Neni 17-d

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e zbatimit të provimit profesional i kryen Inspektorati shtetëror i punës, ndërsa provimin teknikisht e zbaton personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror i zgjedhur nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

#### Neni 17-gj

Provimi profesional për person profesional për siguri gjatë punës zbatohet së paku dy herë në vit.

#### Neni 17-e

(1) Kërkesën për dhënie të provimit, kandidati e parashtron te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Me kërkesën për dhënie të provimit kandidati detyrohet të parashtojë dëshmi për plotësim të kushteve për dhënie të provimit profesional, të përcaktuara me këtë ligj.

#### Neni 17-zh

(1) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës ose personi i autorizuar nga ai, përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënie të provimit profesional.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për dhënie të provimit profesional, mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

#### Neni 17-z

(1) Kandidatit të cilit i është miratuar kërkesa për dhënie të provimit, i caktohet koha dhe vendi për dhënie të provimit profesional, e kandidati njoftohet më së voni në afat prej tetë ditësh para dhënies së provimit profesional.

(2) Kandidatit i mundësohet që të fillojë ta japë provimin profesional në terminin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesës së miratuar për dhënie të provimit profesional.

#### Neni 17-x

(1) Provimi profesional jepet në lokal për dhënien e provimit profesional, të pajisur veçanërisht për dhënien e provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisje për incizimin e dhënies.

(2) Publiku informohet për datën dhe kohën e dhënies së provimit profesional së paku tri ditë para mbajtjes së provimit.

(3) Dhënia e provimit profesional incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

(4) Kriteret në lidhje me kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale-teknike dhe informatike të lokaleve për dhënien e provimit profesional i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(5) Në lokalin për dhënie të provimit profesional, gjatë kohës së dhënies së provimit janë të pranishëm dy përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, një përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Zyrës së Kryetarit të Qeverisë, dhe një përfaqësues nga Komisioni për dhënie të provimit dhe një përfaqësues nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (informatikanë).

#### Neni 17-i

(1) Para fillimit të dhënies së provimit profesional, përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Punës e përcakton identitetin e kandidatit me shikim të letërnjoftimit.

(2) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë të provimit, nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve, ligjeve me koment dhe sqarim, telefonit mobil, aparateve kompjuterike portative dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike, lëndëve të përgatitura paraprakisht dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së dytë të provimit, i lejohet shfrytëzimi vetëm i ligjeve (pa komente dhe sqarime), që në version elektronik gjenden në kompjuterin në të cilin kandidati e jep provimin.

(4) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit profesional, nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me informatikanët nga neni 17-x paragrafi (5) i këtij ligji, në rast se ka problem teknik me kompjuterin.

(5) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohen në këtë afat, provimi profesional ndërpritet vetëm për atë kandidat dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit profesional.

(6) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe ato nuk mënjanohen në afat prej pesë minutash provimi profesional ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin profesional dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit profesional.

(7) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit profesional, vepron në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejme e provimit në atë termin të caktuar.

(8) Në rastet nga paragrafi (7) i këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin profesional dhe kjo konstatohet në procesverbalin për dhënien e provimit profesional.

(9) Përfaqësuesit e autorizuar nga neni 17-x paragrafi (5) i këtij ligji, gjatë kohës së dhënies së provimit profesional nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit që e jep provimin profesional, përveç në rast të mënjanimit të problemit teknik, kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

#### Neni 17-j

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit profesional krijohen shkaqe të arsyeshme për të cilat kandidati nuk mund ta vazhdojë dhënien e provimit profesional (sëmundje, pushim i lindjes dhe ngjashëm), do të ndërpritet provimi për një kohë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

(2) Aktvendim për vazhdimin e provimit miraton ministri kompetent për punët nga sfera e punës me lutje të kandidatit. Lutja parashtrohet në afat prej tetë ditësh nga ndërprerja e shkaqeve për prolongimin e provimit profesional, por më së voni në afat prej gjashtë muajsh.

(3) Nëse kandidati nuk parashtron lutje për vazhdimin e provimit në afatin e caktuar në paragrafin (2) të këtij neni do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin.

(4) Kundër aktvendimit të ministrit kompetent për punët nga sfera e punës nga paragrafi (2) i këtij neni, kandidati mund të ngritë kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(5) Në vazhdimin e provimit profesional, kandidati nuk e jep atë pjesë të provimit profesional të cilën paraprakisht tanimë e ka dhënë.

#### Neni 17-k

(1) Provimi profesional fillon me dhënien e pjesës së parë (pjesës teorike), e pastaj të pjesës së dytë (shembullit praktik).

(2) Pjesa e dytë jepet në afat prej së paku 15 ditësh pas dhënies së suksesshme të pjesës së parë.

(3) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës me Rregullore e përcakton Mënyrën e ndarjes së pikëve në pjesën e parë dhe të dytë të provimit profesional.

#### Neni 17-ll

(1) Pjesa e parë e provimit profesional jepet për çdo sferë përkatëse dhe përmban së paku 50 pyetje me pesë opsione për rrethim prej të cilave njëra është e saktë, dy janë të ngjashme, njëra është e pasaktë në masë të vogël (në të humben numër i vogël pikësh) dhe njëra është e pasaktë në masë të madhe (në të humben numër i madh pikësh).

(2) Kusht për dhënien e pjesës së dytë të provimit është kandidati ta japë pjesën e parë të provimit profesional.

(3) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e parë të provimit profesional në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, do të konsiderohet se provimin profesional nuk e ka dhënë.

#### Neni 17-l

(1) Pjesa e dytë e provimit profesional përbëhet nga shembulli praktik.

(2) Pyetjet të cilat janë pjesë përbërëse e shembullit praktik janë nga sfera përkatëse dhe kanë dhjetë opsione të mundshme përgjigjesh prej të cilave njëra është e saktë, pesë janë të ngjashme dhe katër janë të ndryshme.

(3) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit profesional, do të konsiderohet se provimin profesional nuk e ka dhënë.

#### Neni 17-m

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit profesional bëhet me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetjet e testit varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit profesional kryhet me studim të shembullit praktik dhe përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve që dalin nga shembulli praktik, në formë të zgjidhjes softuerike elektronike (në tekstin e mëtutjeshëm: shembull praktik elektronik).

(4) Pyetjet nga shembulli praktik varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në shembullin praktik.

(5) Pyetjet e përmbytura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit profesional dhe përgjigjet e tyre, si dhe shembulli praktik dhe pyetjet që dalin nga shembujt praktikë dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional.

(6) Sistemi elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni përmban edhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 500 pyetje për çdo sferë, si dhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 100 shembujve praktikë për çdo sferë, për nevojat e pjesës së dytë të provimit.

(7) Në sistemin elektronik përmbahet edhe udhëzim për rregullat dhe literaturën në të cilat përmbahen përgjigjet e pyetjeve nga pjesa e parë e provimit dhe rregullat për pjesën e dytë të provimit.

(8) Numri i pyetjeve dhe shembujve praktikë në bazat nga paragrafi (6) i këtij neni, zmadhohet për 10 % në vit, duke filluar nga viti 2015.

(9) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë dhe të dytë të provimit profesional, kandidati i ka të kapshme në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin profesional, menjëherë pas përfundimit të tij.

#### Neni 17-n

(1) Në ditën e dhënies së pjesës së parë, përkatësisht pjesës së dytë të provimit profesional, përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Punës, kandidati i jep kod të qasjes, përkatësisht fjalëkalim me të cilin i lejohe qasje në sistemin elektronik nga neni 17-m i këtij ligji.

(2) Pas lejimit të qasjes, kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit profesional, përkatësisht shembull praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit, të gjeneruara në mënyrë kompjuterike, përmbytjen e të cilave sipas zgjedhjes së rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga neni 17-m paragrafi (5) i këtij ligji.

(3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit profesional, përmbajnë udhëzim për mënyrën e zgjedhjes së provimit profesional, për të cilin përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Punës jep sqarim, para se të fillojë dhënia e provimit profesional.

(4) Sistemi elektronik për dhënien e provimit profesional nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbytjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit profesional, përkatësisht shembullin praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit në një termin për më shumë se një kandidat.

#### Neni 17-nj

(1) Në rast të pengimit të realizimit të pjesës së parë ose të dytë të provimit profesional për shkaqe që shpijnë në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 17-gj të këtij ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(2) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni mënjanohen në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit profesional, ai vazhdohet menjëherë pas mënjanimit të tyre.

(3) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mënjanohen në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni, provimi ricaktohet për termin tjetër.

#### Neni 17-o

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit profesional, është 120 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin profesional e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

#### Neni 17-p

(1) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga secili prej shembullit praktik të pjesës së dytë, është 120 minuta.

(2) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga shembulli praktik, ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

#### Neni 17-r

(1) Kandidatëve që e kanë dhënë provimin profesional u lëshohet certifikatë në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit profesional.

(2) Formën dhe përmbajtjen e certifikatës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

#### Neni 17-s

Me kërkesë të kandidatit, ministri kompetent për punët nga sfera e punës, për gabimet e bëra në testin për dhënien e provimit profesional, mundëson shikim të drejtpërdrejtë të testit.

#### Neni 17-t

(1) Testet dhe shembujt praktikë shfrytëzohen dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë kohës së dhënies së provimit profesional .

(2) Materialet nga provimet e mbajtura, veçanërisht versionet në letër nga testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit profesional dhe specimenet për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testit dhe shembullit praktik, si dhe incizimet nga provimet e mbajtura ruhen në Inspektoratin Shtetëror të Punës.

(3) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës formon Komision për revizion të provimeve të mbajtura profesionale, që në punën vet i shfrytëzon materialet nga paragrafi (2) i këtij neni dhe në të cilin, krahas përfaqësuesit nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe përfaqësuesit nga Ministria e Shëndetësisë, marrin pjesë edhe përfaqësuesi nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe informatikani nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës i caktuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni, mban mbledhje së paku njëherë në vit dhe kryen revizion të mënyrës së realizimit të së paku dy provimeve të mbajtura në vitin rrjedhës.

(5) Komisioni ka të drejtë të kryejë revizion edhe të mënyrës së realizimit të provimeve të mbajtura në pesë vitet e fundit deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes së komisionit, por jo më herët nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(6) Nëse Komisioni konstaton parregullsi në realizimin e provimit profesional nga individë sipas nenit 17-i të këtij ligji, propozon heqje të Certifikatës nga neni 17-r i këtij ligji.

(7) Ministri miraton Aktvendim për heqjen e Certifikatës në bazë të propozimit të Komisionit në afat prej tri ditësh nga pranimi i propozimit.

(8) Kundër Aktvendimit nga paragrafi (7) i këtij neni mund të ngrihet kontest administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

#### Neni 17-q

(1) Shpenzimet për dhënie të provimit profesional i bartë kandidati nëse institucioni ku është i punësuar nuk i paguan.

(2) Lartësinë e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni, e cakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës në bazë të shpenzimeve të bëra reale për dhënien e provimit, të domosdoshme për realizimin e pjesës së parë dhe të dytë të provimit, përgatitjen e bazave të pyetjeve, realizimin e testit elektronik, përgatitjen e materialeve dhe thirrjeve dhe përgatitjen e certifikatave.

(3) Shpenzimet për dhënien e provimit profesional paguhën në llogarinë e të hyrave personale të ministrit kompetent për punët nga sfera e punës.

(4) Nëse shpenzimet nuk paguhen në llogarinë përkatëse të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, më së voni 15 ditë para ditës së caktuar për zbatim të provimit profesional, kandidati nuk i lejohet dhënia e provimit profesional.

(5) Nëse kandidati në afat prej një viti nga dita e pagimit të mjeteve nuk e jep provimin profesional, mjetet e paguara i kthehen në pajtim me ligjin.

#### Neni 17-u

(1) Certifikatat e dhëna për provim të dhënë profesional për siguri gjatë punës, evidentohen në Regjistrin të cilin e mban Inspektorati Shtetëror i Punës.

(2) Regjistri nga paragrafi (1) i këtij neni, publikohet në ueb faqen dhe në tabelën e shpalljeve të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe në ueb faqen e Inspektoratit Shtetëror të Punës.

(3) Formën dhe përmbajtjen e Regjistrit dhe mënyrën e mbajtjes së tij, i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

#### Neni 17-f

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e vendos sistemin unik elektronik për dhënie të provimit profesional për siguri gjatë punës.

#### Neni 17-h

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, e themelon Regjistrin e personave profesionalë.”

#### Neni 2

Në nenin 46 paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) i cili bëhet paragraf (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Ministri kompetent për punët nga sfera e punës me rregullore e përcakton lartësinë e shpenzimeve për zbatim të procedurës nga paragrafi (1) i këtij neni.”

#### Neni 3

Neni 51 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Për ankesë kundër aktvendimit të inspektorit vendos Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.”

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

#### Neni 4

Gjobë në shumë prej 4 000 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit të autorizuar juridik i cili teknikisht e zbaton provimin nga neni 17-d i këtij ligji nëse nuk e incizon, nuk e emiton drejtpërdrejt në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe nëse nuk e vendos incizimin e provimit të plotë në ueb faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në pajtim me nenin 17-x paragrafi (3) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet përfaqësuesit të autorizuar nga neni 17-i paragrafi (5) të këtij ligji, nëse vepron në kundërshtim me nenin 17-i paragrafi (9) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 4 000 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet institucionit të autorizuar i cili e zbaton provimin nga neni 17-d i këtij ligji, nëse nuk e ndërpret provimin në pajtim me nenin 17-i paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet ministrit kompetent për punët nga sfera e punës nëse nuk e miraton aktvendimin në afatin e përcaktuar nenin 17-t paragrafi (7) të këtij ligji.

Neni 5

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 6

Sistemi unik elektronik vendoset në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 7

Procedurat e filluara për dhënie të provimit profesional për siguri gjatë punës, deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave sipas të cilave kanë filluar.

Neni 8

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa nenet 2 dhe 3 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014, ndërsa nenet 17-a, 17-b, 17-v, 17-g, 17-d, 17-gj, 17-e, 17-zh, 17-z, 17-x, 17-i, 17-j, 17-k, 17-ll, 17-l, 17-m, 17-n, 17-nj, 17-o, 17-p, 17-r, 17-s, 17-t, 17-q, 17-u, 17-f dhe 17-h, do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.